



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

RAPORTI VJETOR I PUNËS

2017

Në kuadër të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 70/2014 për “Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, për përmbushjen e misionit dhe objektit të veprimtarisë së Shërbimit si dhe në zbatim të objektivave e masave të përcaktuara në Programin Vjetor të Punës të miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe Plani Vjetor i Punës së Shërbimit, i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së Nr. 45, datë 15.02.2017, gjatë vitit 2017 puna e strukturave të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat u fokusua në këto drejtime kryesore:

I. Veprimtaria parandaluese

Veprimtaria parandaluese e Shërbimit gjatë vitit 2017 u fokusua kryesisht në:


- Sensibilizimin dhe njohjen e Shërbimit dhe strukturave të saj të posaçme civile për marrjen dhe trajtimin e ankesave dhe denoncimeve të qytetarëve.
- Ankesat dhe denoncimet e publikut – në zbatimin korrekt të protokolleve dhe procedurave standarde të punës.
- Kryerjen e inspektimeve me objekt konkret, duke dalë nga inspektimet rutinore apo panoramike, të fokusuara në problematika dhe fenomene evidente, me synim dokumentimin ligjor të shkeljeve të konstatuara.

Marrëdhëniet me publikun janë një hallkë e rëndësishme e çdo organizate dhe efikasiteti i ndërtimit të kësaj marrëdhënie lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me performancën e agjencive dhe suksesin e tyre në komunikimin me publikun.

Marrëdhëniet me publikun, Shërbimi e ka parë si një urë shumë efektive bashkëpunimi për rritjen e efektivitetit në arritjen e qëllimeve të përbashkëta e në mënyrë të veçantë në luftën kundër korrupsionit, duke i krijuar qytetarëve mundësinë për të qënë faktor kyç në këtë luftë të përbashkët, përmes hapësirave dhe kanaleve të komunikimit që janë krijuar.


Ridimensionimi i marrëdhënieve me komunitetin, nëpërmjet ndryshimit të sjelljes, të të vepruarit dhe të qasjes së Shërbimit ndaj zgjidhjes së problematikave të qytetarëve si dhe shërbimit të ofruar, reflektohet në treguesit sasiorë e cilësorë të veprimtarisë në marrjen, trajtimin dhe hetimin administrativ të ankesave gjatë vitit 2017. Konkretisht strukturat e SH.Ç.B.A-së, kanë marrë dhe trajtuar:

- Telefonata të publikut në Linjën e Gjelbër – **6439** telefonata.
- Ankesa të marra në nivel qendror dhe vendor – **1048** ankesa




Nga analiza e gjithë produktit të përfutur gjatë hetimit administrativ të ankesave, trendi i shkeljeve administrative mbizotërohet nga:

- “Mosveprim të strukturave të policisë”,
- “Vendosje gjobe në mënyrë të padrejtë”,
- “Abuzim me detyrën”,
- “Shkelje të normave të etikës”,
- “Shkelje të procedurave standarde të punës”.




Statistika tregon se, në ndryshim nga viti 2016 ku numrin më të madh të ankesave e zinte “Gjobe e padrejtë”, me **190 të tilla**, gjatë vitit 2017 kanë patur një rritje të konsiderueshme ankesat për “Mosveprim të strukturave të policisë”, me **274 ankesa**, kjo edhe për shkak të natyrës së këtyre ankesave pasi kanë të bëjnë kryesisht me zgjidhje konfliktesh të natyrave të ndryshme, të zakonshme në jetën komunitare.

Ndërsa, strukturat për të cilat ka patur një numër më të madh ankesash nga publiku, kanë qenë ato Drejtori Vendore të Policisë ku është përqëndruar edhe numri më i madh i popullsisë së vendit dhe dinamika e jetës është tepër aktive, gjë që ka bërë që edhe problematika e hasur nga Policia e Shtetit dhe trajtimi i tyre të jetë më e madhe dhe e shumëllojshme. Kështu, DVP e Tiranës ka patur numrin më të lartë të ankesave, pasuar nga DVP-të Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë duke vazhduar më pas me DVP-në Gjirokastër, Kukës e me rradhë.




Ky përmirësim apo rritje e bashkëpunimit publik-Shërbim, del qartë edhe në grafikun e mëposhtëm, i cili paraqet burimin e marrjes së ankesave të publikut gjatë vitit 2017 nga SH.Ç.B.A ku mbizotëron me një numër prej **261 ankesash apo denoncimesh** që qytetarët, në kontakt të drejtpërdrejtë me punonjësit tanë, i kanë adresuar ato pranë strukturave vendore dhe qendrore të Shërbimit.



Nga trajtimi i ankesave në tërësi gjatë periudhës analizuese, ka rezultuar se;

- Në **7 raste**, nga **11** punonjës policie janë gjetur shkelje ku janë konstatuar elementë të veprës penale, duke bërë referimin e materialeve pranë organit të Prokurorisë, për punonjës in objekt të ankimit.
- Në **87 raste**, nga **120** punonjës policie janë gjetur shkelje të karakterit administrativ, duke sugjeruar fillimin e ecurisë disiplinore nga Drejtoria e Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit, për punonjës in objekt ankimi;
- Në rastet e tjera, veprimet e punonjësve kanë qenë konform rregullave dhe Procedurave Standarde të Punës.



Kontrolli dhe vlerësimi i Strukturave në zbatimin e ligjshmërisë gjatë përmbushjes së detyrës së tyre funksionale.

Gjatë vitit 2017, Sektori i Inspektimit të Përgjithshëm, në Drejtorinë e Inspektimit & Ankesave të Shërbimit, në funksion të vlerësimit dhe kontrollit të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, kreu inspektime me qëllim përcaktimin nëse veprimtaria e strukturave ka qenë në përputhje me ligjet në fuqi dhe procedurat standarde të punës që rregullojnë veprimtarinë e tyre, për të parë nivelin e përputhshmërisë së veprimtarisë së tyre në raport me pritshmëritë e publikut, me synimin që strukturat e inspektuara të ballafaqohen me konstatimet dhe

rekomandimet e dhëna për të përmirësuar dhe rritur treguesit e punës dhe për të qenë më efektive në përmbushjen e objektivave dhe arritjes së qëllimit të përbashkët; rritjen e besimit të publikut nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe performancës së organeve publike.

Kështu, në zbatim të Planit Vjetor të Inspektimeve dhe problematikave të dala gjatë vitit, Shërbimi ka arritur këto rezultate:

Janë kryer **gjithsej 53 inspektime**, konkretisht:

- 8 inspektime të planifikuara,
- 17 inspektime të paplanifikuara,
- 2 inspektime në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit,
- 4 inspektime në bashkëpunim me strukturat e tjera,
- 22 inspektime për trajtim ankesash,

Subjekt i inspektimeve kanë qenë më së shumti strukturat vendore të Policisë së Shtetit pasi edhe problematikat e shfaqura kanë qenë më evidente dhe kjo për shkak të natyrës së punës dhe impaktit të drejtpërdrejtë dhe të dukshëm në publik të veprimeve të këtyre strukturave, por subjekte të inspektimeve kanë qenë edhe struktura të Gardës së Republikës si dhe të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Tematika e inspektimeve ka qenë e ndryshme dhe është përcaktuar nga problematikat e evidentuara nga viti i kaluar në rastin e inspektimeve të planifikuara, por gjithashtu edhe nga problematika e dalë gjatë dinamikës së përditshme të punës së Shërbimit, si edhe nga indikatorë të tjerë të jashtëm (media, ankesa, denoncime) që prekin aspekte të veçanta të punës së strukturave objekt inspektimi.

Në përfundim të hetimit administrativ të inspektimeve, për personat përgjegjës për shkeljet e evidentuara:

- Është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për **147** punonjës,
- Janë referuar materialet për fillimin e procedimit penal për **19** punonjës,
- Janë evidentuar **147 konstatime e konkluzione**,
- Janë dhënë **70 rekomandime** për ndjekje nga strukturat objekt inspektimi.

Tregues statistikor krahasimor:

Rezultatet Periudha	Inspektime të planifikuara	Inspektime të paplanifikuara	Inspektim në bashkëpunim me struktura të tjera	Inspektim për trajtim ankesash	Referuar nr. punonjësish	Sugjeruar ecuri disiplinore nr. punonjësish
Viti 2016	12	5	4	43	4	188
Viti 2017	8	17	6	22	19	147

Krahasuar me vitin e kaluar ka një rritje të dukshme të inspektimeve të paplanifikuara, diktuar kjo nga problematika e dalë nga dinamika e punës së Shërbimit si dhe një rritje të numrit të referimeve penale, ç'ka nxjerr në pah cilësinë e inspektimeve të kryera.

xxx

Binomi zbulueshmëri – ndëshkueshmëri, qoftë kjo me masa administrative, ka qenë i frytshëm edhe gjatë vitit 2017, pasi bashkëpunimi me Drejtorinë e Standardeve Profesionale ka qenë shumë rezultativ. Mbi bazën e materialeve të dërguara nga strukturat e Shërbimit, mbi ecurinë e hetimeve administrative apo penale për punonjës policie, Drejtoria e Standardeve Profesionale ka përfunduar hetimin disiplinor për **150** punonjës policie, duke rekomanduar masa disiplinore, konkretisht:

Masa të rënda disiplinore:

- **5 raste** është dhënë masa disiplinore “*Përfshirje nga Policia*”,
- **47 raste** është dhënë masa disiplinore “*Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet*”
- **1 rast** është dhënë masa disiplinore “*Mbajtja e pagës në masën 5 ditë pune*”

Pra për shkelje të rëndë disiplinore janë ndëshkuar **gjithsej 53 punonjës policie**.

Masa të lehta disiplinore:

- **64 raste**, është rekomanduar D.V.P-ve/DVKM-ve dhënia e masës disiplinore për shkelje të lehtë disiplinore,
- **20 raste** është rekomanduar për masë parandaluese,
- **12 raste** është përfunduar hetimi disiplinor pasi nuk provohet shkelja e pretenduar,
- **1 rast** praktika është arshivuar.

Në total janë ndëshkuar me masë disiplinore, iniciuar nga Shërbimi, **150** punonjës policie.


II. Rritja e kapaciteteve dhe cilësisë së hetimit në zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundërligjshme të punonjësve të Strukturave.

Në funksion të hetimit penal, nga strukturat vendore dhe qendrore të Shërbimit, për vitin **2017** janë dërguar pranë organit të Prokurorisë materialet kallëzuese ndaj punonjësve të strukturave që dyshohet se kanë kryer elementë të veprës penale, e konkretisht:


- **200** kallëzime penale për
- **284** persona, nga të cilët:
 - **78** punonjës policie i nivelit të parë drejtues,
 - **182** punonjës policie të nivelit zbatues,
 - **17** punonjës policie civil,
 - **6** punonjës të Gardës së Republikës
 - **1** punonjës i PMNZSH dhe
 - **11** shtetas.

Arrestuar në flagrancë/ndaluar **64** persona, nga të cilët **12** punonjës policie të nivelit të parë drejtues, **36** punonjës policie niveli zbatues, **1** punonjës policie civil, **2** efektiv të Gardës dhe **13** shtetas.

Grafik krahasues



Nga analiza e informacioneve të grumbulluara dhe materialeve referuese në prokurori, edhe për vitin 2017 trendi i veprave penale vazhdon të jetë i njëjtë, e konkretisht:



Format e shfaqjes së korrupsionit në polici, janë evidentuar në format e:

- Shpërdorimit të detyrës me tendencën për marrje rryshfeti.
- Favorizimit apo implikimit në veprimtari të kundraligjshme si: kultivimi i bimëve narkotike; trafiku i drogës, kontrabandës, etj, me synim marrjen e përfitimeve nga ky aktivitet i kundërligjshëm.
- Pasivitetit negativ në përmbushjen e detyrës me synim marrjen e një përfitimi moral dhe material.

xxx

Monitorime

- Pjesmarrja e specialistëve të Shërbimit në grupet e përbashkëta të monitorimit me strukturat e Policisë së Shtetit në të gjitha qarqet e vendit, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në Urdhrin e Përbashkët të Drejtorit të Policisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së Nr. 36, datë 21.02.2017 “*Mbi masat që duhen marrë mbi evidentimin dhe goditjen e fenomenit të sigurimit të farërave, kultivimit të fëdanëve dhe bimëve narkotike në sera diellore, tunele të braktisura, ish-rezerva shtetërore dhe çdo ambient tjetër të mundshëm për përdorim nga grupet kriminale*”.
- Në kuadër të fushatës informuese e sensibilizuese për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, të ndërmarrë nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe

Ankesat, gjatë periudhës Mars – Prill 2017, janë zhvilluar takime në Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë: Zall-Herr, Shëngjergj, Petrelë, Bërzhitë; në Njësitë Administrative të qarkut Berat: Otlak (Lapardha) dhe Kozarë; në Njësitë Administrative të Qarkut Fier Dermenas, Dushk dhe në Bashkinë Mallakastër; në fshatrat Nikël dhe Tapizë të qarkut të Durrësit. Përfaqësuesit e këtyre Njësive Administrative u vunë në dijeni për funksionin dhe rolin e SHÇBA-së, si dhe u informuan më shumë rreth fushatës anti-kanabis, shpërblimit që ofrohet në rast të informacioneve të vlefshme. Një interes për punën tonë paraqet informimi edhe për rastet kur në këtë veprimtari implikohen punonjës të Policisë së Shtetit dhe për këtë u dha garanci lidhur me ruajtjen e anonimatit.

Në Njësitë Administrative të sipërpërmenduara u vizituan dhe u mor kontakt me drejtuesit e nxënësit e shkollave si: Shkolla e Mesme e Bashkuar “Povelçë”, Dermenas; Shkolla e Mesme “Ibrahim Hasmene”, Bërzhitë; Shkolla e Mesme e Bashkuar “Kemal Atatürk”, Zall – Herr; Shkolla e Mesme “Koço Brisku, Otlak dhe Shkolla e Mesme “Ramazan Karaj”, Nikel, të cilët u informuan në lidhje me veprimtarinë e Shërbimit, me fushatën e ndërmarrë duke ju shpërndarë edhe fletëpalosjet informuese për këtë fushatë.

III. Menaxhimi i burimeve njerëzore, edukimi, trajnimi, logjistika e financa

– Rekrutimet, emërimet, transferimet, lirimet nga detyra

Gjatë vitit u kryen:

- 2 procedura konkurimi për pranime të reja në Shërbim, me;
 - o 12 kandidatë pjesmarrës, nga të cilët;
 - o 8 kandidatë fitues,
 - o 7 prej të cilëve u emëruan në pozicionet vakante.

U bënë 8 emërimet të reja, 1 prej të cilëve është me kontratë të përkohshme, në pozicionin Nd/Specialist.

Janë larguar nga shërbimi 7 punonjës;

- 5 punonjës me motivacionin “Me kërkesën e tij” dhe
- 2 punonjës me motivacionin “Mbush moshën për pension pleqërie”.

Gjithsej gjatë vitit u bënë 12 transferime punonjësish për nevoja pune.

– **Edukim, trajnim i personelit**

Gjatë vitit 2017 u zhvilluan **5** trajnime ku morën pjesë **51 punonjës**, nga të cilat:

- **3** trajnime për “Ngritjen në gradë për punonjësit e Shërbimit”,
- **1** trajnim **3** javor me punonjës pa gradë të Shërbimit
- **1** trajnim i brendshëm me punonjës të Shërbimit.

Gjatë vitit, përfaqësues të Shërbimit morën pjesë në seminare, trajnime dhe workshope të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, me tematika të ndryshme, ku morën pjesë **6** specialistë të Shërbimit.

– **Spektori i buxhet - financës:**

Për vitin 2017 Shërbimit ju akorduan fonde buxhetore në shumën prej:

- **192,419,360 lekë**, bazuar kjo në kërkesat tona të paraqitura gjatë fazës së planifikimit buxhetor afatmesëm.
- Realizimi është në shumën prej **185,368,924** lekë ose në masën **96%**.

Më poshtë paraqesim pasqyrën përmbledhëse të realizimit të shpenzimeve buxhetore si dhe faktorët që kanë ndikuar në mos realizimin e planit të miratuar;

(në lekë)

Nr.	Art.	Emërtimi	Plani	Realizimi	Diferenca	Real. në %
1.	600	Paga dhe shpenzime të tjera personeli	119,823,000	117,471,364	2,351,636	98%
2.	601	Kontribute për sigurime shoqërore & shëndetësore	20,144,000	19,268,261	875,739	96%
3.	602	Mallra e shërbime	25,000,000	23,426,147	1,573,853	94%
4.	606	Transferime për buxhetet familjare dhe individët	2,958,360	1,719,952	1,238,408	58%
5.	231	Investime	24,494,000	23,483,200	1,010,800	96%
TOTALI			192,419,360	185,368,924	7,050,436	96%

IV. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2018

Për vitin në vazhdim, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, objektivat dhe programin e punës të Ministrisë së Brendshme si dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji organik i Shërbimit, parashikon të ketë këto përparësi në punën e tij:

1. Thellimin dhe përsosjen e luftës kundër paligjshmërisë në rradhët e strukturave objekt i punës së Shërbimit, për të zbuluar, parandaluar dhe ndëshkuar në kohë çdo lloj forme të shfaqjes së saj.
2. Vazhdimin me përkushtim dhe angazhimin e mëtejshëm të personelit dhe strukturave përkatëse të Shërbimit, për kryerjen e procedurave verifikuese për kontrollin e figurës së subjekteve të rivlerësimit, në zbatim të detyrimeve dhe kërkesave të ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Angazhimin dhe dhënien e kontributit maksimal në procesin e pritshëm të Vetting-ut që do të bëhet për punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.
4. Vazhdimin me prioritet të veprimtarisë parandaluese dhe luftës kundër rasteve të kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, në kuadër të objektivave dhe masave konkrete që rrjedhin për SH.Ç.B.A-në nga Plani i Veprimit Kombëtar Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017 – 2020.
5. Në kuadër të ndryshimeve të domosdoshme ligjore, do të përgatiten të gjitha propozimet për ndryshimet dhe shtesat që parashikohen të bëhen në ligjin 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” dhe akteve të tjera nënligjore të dalë në zbatim të tij.
6. Hartimin dhe propozimin e ndryshimeve strukturore që parashikohen të bëhen në përputhje me prioritetet e vendosura dhe në reflektim të ndryshimeve ligjore dhe nënligjore.
7. Realizimin e investimeve të planifikuara për përmirësimin dhe riaftësimin e mjeteve dhe teknologjisë tekniko – shkencore në funksion të rritjes së kapaciteteve të punës informative dhe hetimore të Shërbimit.
8. Investimi në teknikë dhe automjete për strukturat e Shërbimit, në funksion të përmirësimit dhe rritjes së performancës së Shërbimit në të gjitha fushat e aktivitetit të tij.

9. Nxjerrjen e nevojave dhe rritjen e kërkesës për trajnime në Akademinë e Sigurisë, misionet këshillimore e monitoruese që asistojnë Ministrinë e Brendshme me qëllim forcimin e kapaciteteve njerëzore të Shërbimit.
10. Vazhdimin me ritme të larta të dixhitalizimit të të gjithë fondit të dokumentacionit që administrohet nga Sekretaria dhe Zyra e Kartotekës së Shërbimit, për përfundimin e të gjithë procesit deri në fund të vitit në vazhdim.